



**VENDIM**

**Nr. 150, Datë 30.09.2016**

**MBI**

**KËRKESAT E KESH SH.A DHE MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIË PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 144, DATE 25.08.2016 TË BORDIT TË ERE, “PER MIRATIMIN E KONTRATES TIP PER SHIT-BLERJE TE ENERGJISE ELEKTRIKE NDERMJET SHOQERISE SE PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE, AKSIONET E SE CILES KONTROLLOHEN PLOTESISHT APO PJESERISHT NGA SHTETI/KESH SH.A. DHE FURNIZUESIT TE SHERBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SH.A. PER PERIUDHEN 01.07.2016- 31.12.2016”**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, dhe nenit 16 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2016, Bordi i ERE-s mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtorite Teknike, në lidhje me kërkesat e KESH sh.a dhe MEI për rishikimin e vendimit nr. 144, date 25.08.2016 të Bordit të ERE, “Për miratimin e kontratës tip për shit-bletje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a. për periudhën 01.07.2016-31.12.2016”

**Konstatoi se:**

- Shoqëria KESH sh.a. ka marrë dijeni për vendimin e ERE nr. 144 datë 25.08.2016 nëpërmjet shkresës së ERE nr. 644 Prot., datë 30.08.2016.
- MEI ka marrë dijeni për vendimin e ERE nr. 144 datë 25.08.2016 nëpërmjet shkresës së ERE nr. 642 Prot., datë 30.08.2016
- Shoqëria KESH sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën nr. 7455/1 Prot., datë 07.09.2016, protokolluar me tonën nr 644/1, datë 08.09.2016, për rishikimin e vendimit nr. 144, datë 25.08.2016 të Bordit të ERE.
- Pika 5 e nenit 16 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe Neni 16 i “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016”,

parashikon se: *Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.*

- Kërkesat e KESH sh.a. dhe MEI për rishikimin e vendimit nr. 144 datë 25.08.2016, janë depozituar jashtë afatit të parashikuar më sipër.
- Nga KESH dhe MEI nuk janë paraqitur prova të reja të cilat te çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai nr. 144 datë 25.08.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e KESH sh.a, për rishikim e vendimit nr. 144, date 25.08.2016 të Bordit të ERE, "Per miratimin e kontrates tip per shit-blerje te energjise elektrike ndermjet shoqerise se prodhimit te energjise elektrike, aksionet e se ciles kontrollohen plotesisht apo pjeserisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit te Sherbimit Universal/OSHEE sh.a. per periudhen 01.07.2016- 31.12.2016" te paraqitur jashte afatit te percaktuar ne ligj.
2. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e MEI për rishikim e vendimit nr. 144, date 25.08.2016 të Bordit të ERE, "Per miratimin e kontrates tip per shit-blerje te energjise elektrike ndermjet shoqerise se prodhimit te energjise elektrike, aksionet e se ciles kontrollohen plotesisht apo pjeserisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit te Sherbimit Universal/OSHEE sh.a. per periudhen 01.07.2016- 31.12.2016" te paraqitur jashte afatit te percaktuar ne ligj .
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a, Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**